



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 3121 / Prot
2

Shkodër, më 10. 09 .2026

Lënda: Publikim njoftimi në Buletin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK


(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"- Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike të radhës për dy vende pune.

Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI

Prof. dr. Blerita DRAGSHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 3121 Prot

Shkodër, më 10 . 09 .2026

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune në fushen e të Drejtës Ndërkombëtare Penale, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane, në pozicionin Profesor ose Profesor i Asociuar me kohë të plotë për vitin akademik 2026-2027, për leksionet dhe seminarët e lëndës "E drejtë ndërkombëtare penale" (programi i studimit "Master i Integruar në Drejtësi") dhe "Gjykatat ndërkombëtare" (programi i studimit MSC "E drejtë private dhe e biznesit").

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të jenë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushen e "Drejtësisë" në sistemin me kohë të plotë. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, e noterizuar.
2. T'i përkasin kategorisë "Profesor".
3. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, me nivel jo më të ulët se B2 (notë jo më të ulët se tetë), të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Preferohen kandidatët që kanë :
 - 4/1. Përvojë të mëparshme në mësimdhënie në fushen e së drejtës ndërkombëtare penale.
 - 4/2. Eksperiencë studimore dhe kërkimore në fushen e së drejtës ndërkombëtare penale, në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna dhe nuk është provuar largimi i padrejtë me vendim gjyqësor.

7. Të mos kenë dëmtuar publikisht imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje **familjare** (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), **gjinie** (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë ku kërkojnë të punësohen si dhe të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresën www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim- pedagog të brëndshëm)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Kopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, të noterizuara.
4. Kopje e noterizuar e gradës shkencore "Doktor" dhe titujve akademikë të fituar dhe/ose dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare. Për dëshmitë e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga ministria përgjegjëse, të noterizuara.
5. Tre rekomandime nga të cilat të paktën dy prej mësimdhënësve me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurren dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi penaliteti.
10. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë.
11. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore dhe/ose konflikt interesi).
12. Fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik. (me shënimin "Për konkursin e Juridikut")
- Konkursi do të zhvillohet me dosje brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit etj. , t'i drejtoheni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

R E K T O R I

Prof. dr. Blerta DRAGUSHA